
AKTI I THEMELIMIT ITALFLUID GROUP ALBANIA SHPK

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.)

Sot, me date 19/02/2020, te nenshkuarit:

a) Znj. Concetta Benigni, atesia Carmine, shtetase italiane, lindur ne Corfinio (AQ) dhe banuese ne Itali, me adrese RAIANO, Orafi Benievenga 21, (AQ), Itali, lindur me 26.08.1972, mbajtese e kartes se identetit me nr. AT8145764.

b) Shoqeria e huaj "ITALFLUID GROUP S.R.L." e regjistruar ne Itali, me kod fiskal 01866550690 dhe me adrese te selise, Rruga Colonna, 50 – 66100 Chieti (CH), Itali.

Me vullnetin tone te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr, 9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (Ligji i shoqerive) kemi vendosur te krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ITALFLUID GROUP ALBANIA" ("Shoqeria") duke nenshkuar kete Akt Themelimi.

Neni 1. **Emri dhe forma ligjore**

- 1.1. Emri i shoqerise eshte "ITALFLUID GROUP ALBANIA" ("Shoqeria), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", i cili perfaqeson formen ligjore te saj. Shoqeria do te prezantohet dhe do te zhvilloje aktivitetin e saj duke perdorur emrin "ITALFLUID GROUP ALBANIA"
- 1.2 Shoqeria eshte entitet ligjor shqiptar dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008. " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (Ligji i shoqerive).

Neni 2. **Selia dhe kohezgjatja**

-
- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : **Druga Tefta Tashko, Pallati 20, Hyrja 14, Apartamenti 10, Tiranë**. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë seline e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.

Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyrë përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

- 2.2 Kohezgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 3. **Objekti i veprimtarisë**

- 3.1. Objekti i veprimtarisë të Shoqërisë është :

- ekzekutimi i shërbimeve reale dhe të punës për kërkime të naftës dhe gjeotermike, marrjen e tenderave për transportin e pajisjeve dhe mallrave, punime të mirëmbajtjes, ushtrime dhe testet e prodhimeve të naftës, gjeotermike dhe energjitike. Ajo mund të kryejë konsulence energjitike dhe ndihmë teknike për prodhimin e naftës, projektimin, ndërtimin, shitjen dhe mirëmbajtjen e aparaturave industriale dhe të sistemeve të kontrollit, montimin dhe rimontimin e tyre, kontrolle jo shkatërruese, kalibrimi i instrumentave matëse, të rejtat teknologjike në sektorin e energjisë dhe të zhvillimit të hardwareve dhe softwareve. Shoqëria mund të jetë në gjendje të realizojë shërbimet e saj në shqiptari dhe jashtë vendit dhe mund të nënshkruajë kontrata shërbimi konsultimi dhe furnizimin e mallrave, duke vënë në dispozicion infrastrukturen dhe punonjësit e saj;
- menaxhimi i kurseve të trajnimit dhe të gjithë përfitimet për personelin shqiptar dhe të huaj;
- pastrimin dhe mirëmbajtjen e çdo lloji aparature industriale dhe pajisjeve të rafinerisë së naftës;
- aktivitetet e përgjithshme të ndërtimit, përfshirë ndërtimet e godinave industriale, tregtare dhe bujqësore, si për llogari të vete ashtu edhe për llogari të tretëve, ristrukturimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen e këtyre ndërtësive, nderimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, shesheve dhe veprave të ujërave të zeza;
- tregtine me shumicë të siliciumit, të hekurit, aluminit, xhamit, shufrave dhe paneleve të silicit, të qelizave dhe moduleve fotovoltaike, modeleve diellore në përgjithësi, impianteve eolike, impianteve të biogazit, impianteve fotovoltaike, si dhe impianteve, aparaturave,

-
- aksesore dhe gjithcka tjeter ne pergjithesi me qellim prodhimin e energjise nga burime te rinovueshme, ndihmen teknike, mirembajtjen dhe furnizimin e materialeve dhe pjeseve te kembimit;
- shitje, instalimin dhe montimi, te materialeve elektrike, hidraulike te impianteve teknike, te kondicionimit;
 - ndertimi dhe mirembajtja e prodhimeve, struktura dhe ndertime civile dhe industriale, ne hekur, celik dhe qelq;
 - menaxhimi i mencave te ndermarrjeve dhe organeve publike, administrimin dhe shperndarjen e pijeve dhe ushqimeve, perfshire shitjen e produkteve ushqimore menaxhimi i vetesherbimit ne njesite publike dhe private, manaxhimi i restoranteve, bar hoteleve, pub, piceri, pasticeri dhe te gjitha produktet ushqimore dhe joushqimore ne pergjithesi dhe te aktivitetet e tjera te lidhura ose plotesuese me objektin social.
 - ajo mund te kryeje gjithashtu te gjitha veprimet e pasurise se luajtshme dhe te paluajtshme (duke perjashtuar ato aktivitete te rezervuara nga ligji per ato shoqeri qe plotesojne kerkesa te vecanta) financiare dhe qiraje (me perjashtim te qirave financiare), te vleresuara nga organi administrativ si te domosdoshme ose te dobishme per vijimin e objektit te shoqerise :te ndermarre, drejte per drejte ose jo drejte per drejte, interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera, konsorciume dhe shoqeri qe kane objekt te ngjashem ose te perafert ose jane te lidhura me te sajjin, te ndermarre kredi dhe financime duke perfituar nga te gjitha lehtesirat e kredise dhe ato tatimore te parashikuara ne ate moment nga legjislacioni ne fuqi, te jape garanci pasurore, fidejusione dhe garanci, si per obligimet e veta ashtu edhe per ato te treteve, me saktesimin qe keto aktivitete financiare mund te kryhen vetem nga aktivitete jo dominuese dhe sidoqofte jo kundrejte publikut,ne respekt te ligjeve ne fuqi.
 - Shoqeria ne perputhje me legjislacionin ne fuqi mund te realizoje te gjitha veprimtarine e mundshme ne fushen komerciale industriale financiare imobiliare per te realizur objektin e shoqerise.

Neni 4.
Kapitali fillestar dhe ndarja e tij

- 4.1 Kapitali i Shoqerise eshte ne total 10,000 (dhjetemije) leke, i ndare ne 2 (dy) kuota, plotesisht te nenshkruara nga Ortaket.



4.2 Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si me poshte :

a) Znj. Concetta Benigni, atesia Carmine, shtetase italiane, lindur ne Corfinio (AQ) dhe banuese ne Itali, me adrese Raiano (AQ), Via Orafi Benievenga 21, Itali, lindur me 28.08.1972, mbajtese e kartes se identitetit me Nr. AT8145764, zoteruese e 1 (nje) kuote, me vlere nominale 5,100 leke, me pjemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 51%.

b) Shoqeria e huaj "ITALFLUID GROUP S.R.L." e regjistruar ne Itali, me kod fiskal 01866550690 dhe me adrese te selise Rruga Colonna, 50 – 66100 Chieti (CH), zoteruese e 1 (nje) kuote, me vlere nominale 4,900 leke, me pjemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 49%.

Neni .5 **Organet drejtuese dhe Administrimi**

5.1 Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj jane si me poshte :

- (i) Asambleja e ortakeve
- (ii) Administratori

5.2 Kompetencat e Asamblese se Otakeve dhe te Administratorit do te percaktohen ne Statutin e shoqerise

5.3. Administratori i shoqerise do te jete Z. LORENZO ZUCCARO, atesia Giovanni, lindur me 30.08.1967, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. AU8381812, lindur ne Loreto Aporutino (PE) Itali dhe banues ne adresen Cappelle sul Tavo (PE) Itali..

Neni 6. **Te tjera**

6.1 Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete Akt Themelimi, do te rregullohet nga dispozitat e Statutit te Shoqerise, Ligjit te Shoqerive dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.



-
- 6.2. Ky Akt Themelimi hartohet dhe nenshkruhet nga ortaket e Shoqerise, sot me date 19.02.2020 ne kater kopje.

ORTAKET E SHOQERISE

ITALFLUID GROUP S.R.L.

E perfaqesuar nga
LORENZO ZUCCARO

LORENZO ZUCCARO 

Concetta Benigni

